

# VOTIMI NGA JASHTË 2019

ANALIZË E VOTIMIT NGA JASHTË  
NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)  
Schweizerische Eidgenossenschaft Confédération suisse  
Confederazione Svizzera Confederaziun svizra  
Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC)



---

PRISHTINË, MARS 2020

Të drejtat e autorit © 2020. GERMIN  
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përveç citimeve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, fotokopjues, ose tjetër, pa lejen paraprake të autorit.

---

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Organizatës GERMIN dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

## **HYRJE**

6

## **VOTA E DIASPORËS 2019**

NUMRI I APLIKIMEVE,  
APROVIMEVE DHE  
VOTAVE TË VLEFSHME 13

PAKOT ME FLETËVOTIME  
NGA JASHTË PËR ZGJEDHJET  
PARLAMENTARE - 2019 15

VOTAT E VLEFSHME SIPAS  
SHTETEVE DËRGUESE 18

PAKOT ME FLETËVOTIME TË  
ARDHURA NË KQZ PAS  
AFATIT LIGJOR 19

## **E DREJTA E VOTËS NGA JASHTË VENDIT**

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM  
VOTIMI JASHTË VENDIT? 9

RËNDËSIA E DIASPORËS 9

KORNIZA LIGJORE 10  
PROCEDURA E REGJISTRIMIT  
SI VOTUES JASHTË VENDIT

PROCEDURAT E VOTIMIT 11

**PENGESAT NË  
PROCESIN E VOTIMIT  
NGA JASHTË** 21

## **REKOMANDIME**

23

## **BIBLIOGRAFIA**

26



## HYRJE

Qytetarët e Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen njësoj sikurse të gjithë të tjerët që jetojnë në Kosovë. Republika e Kosovës përmes legjislacionit të saj mundëson ushtrimin e të drejtave zgjedhore për të gjithë qytetarët pa dallim, pavarësisht vendit ku ata jetojnë. Të drejtat zgjedhore hyjnë në kuadrin e të drejtave themelore, dhe garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjet në fuqi. Në Kosovë **votimi nga jashtë vendit lejohet për të gjitha llojet e zgjedhjeve**. Qytetarët jo-rezidentë mund të votojnë përmes postës në Zgjedhjet Lokale apo Qendrore, pasi të jenë regjistruar suksesshëm për votim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Mirëpo, edhe pse ekziston një numër i madh i qytetarëve që jetojnë jashtë vendit, pjesëmarrja e tyre në Zgjedhje në Kosovë vazhdon të mbetet e ulët. Votimi nga jashtë vendit, që prej zgjedhjeve të para, pas shpalljes së pavarësisë, nuk është trajtuar me prioritet dhe problemet e raportuara gjatë cikleve zgjedhore nuk janë adresuar mjaftueshëm. Kjo ka bërë që potenciali elektorale jashtë vendit ta ketë të vështirë pjesëmarrjen në proceset demokratike në vendin e origjinës, gjë e cila ka ndikuar edhe në besueshmërinë e tyre ndaj institucioneve në Republikës së Kosovës.




**KJO ANALIZË SYNON TË  
ADRESOJË PENGESAT NË  
PROCESIN E VOTIMIT NGA  
JASHTË ME QËLLIM TË  
RRITJES SË PJESËMARRJES  
SË PJESTARËVE TË  
DIASPORËS NË ZGJEDHJE  
NË KOSOVË.**



Një numër i madh i vëshguesve dhe monitoruesve pajtohen që proceset zgjedhore në Kosovë kanë pasur përgjithësisht ngritje të cilësisë me kalimin e viteve. Mirëpo, kjo nuk është reflektuar edhe në pjesën e votimit nga jashtë vendit. Problemet në procesin e aplikimit për t'u kualifikuar si votues nga jashtë, komunikimi i ngadaltë dhe informimi i dobët, si dhe problemet me dërgimin dhe pranimin e zarfeve me fletëvotime kanë përcjellë pothuajse çdo cikël zgjedhor dhe vazhdojnë të jenë aktuale. Edhe pse që nga zgjedhjet e vitit 2017 KQZ ka bërë disa ndryshime, duke ofruar opsionin e aplikimit përmes emailit zyrtar, votimi nga jashtë vendit, siç u dëshmuar edhe me zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, vazhdon të mbetet sfidues.

Kjo analizë synon të adresojë pengesat në procesin e votimit nga jashtë me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së pjestarëve të diasporës në Zgjedhje në Kosovë. Analiza paraqet të dhënat mbi votimin nga jashtë gjatë zgjedhjeve të fundit për Kuvendin e Kosovës të vitit 2019. Në këtë dokument trajtohen: rëndësia e të drejtës e votës, procedurat dhe pjesëmarrja në zgjedhje e qytetarëve jashtë vendit, rezultatet e votimeve dhe pengesat gjatë procesit. Po ashtu, në pjesën e fundit jepen rekomandime konkrete për institucionet relevante për ndryshimet që duhen bërë me qëllim të tejkalimit të pengesave dhe zgjerimit të mundësive për votim nga jashtë.



**eDREJTA  
eVOTËS  
NGA  
JASHTË  
VENDIT**



## PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM VOTIMI JASHTË VENDIT?

Për një vend si Kosova, përfshirja e diasporës në proceset politike është mjet i rëndësishëm për të mbajtur të forta lidhjet me qytetarët jashtë vendit. Votimi i diasporës është edhe mjet shtesë për ruajtjen e përkatësisë kombëtare dhe forcimin e identitetit etnik. Ndër aspektet e ndryshme të vendit të origjinës në të cilin diaspora duhet të përfshihet ngushtë, pjesëmarrja politike është mbase njëra nga më të rëndësishmet. Në këtë drejtim, votimi nuk është vetëm forma më e rëndësishme e pjesëmarrjes politike, por edhe mënyra më e mirë për t'i bërë zërat e diasporës të dëgjohen. Poashtu, ofrimi i mundësive për të ushtruar të drejtën e votës tregon edhe për interesimin e shtetit për të trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët pa dallim të vendit ku jetojnë. Siç deklaroi Raporti për votimin jashtë vendit i Komisionit të Venedikut për vitin 2011, votimi nga jashtë është edhe mekanizëm i trajtimit të barabartë midis qytetarëve që banojnë në vend dhe anëtarëve të diasporës. Sipas Komisionit të Venedikut, është në diskrecionin e shteteve të të përfshijnë në legjislacionin e tyre të drejtën e votimit nga jashtë. Mirëpo, kur shtetet ua japin të drejtën qytetarëve jo-rezidentë për të votuar, atëherë ato duhet të sigurojnë të gjitha mundësitë për ushtrimin e kësaj të drejte nga qytetarët jashtë vendit, njësoj sikurse të tjerët brenda vendit.

## RËNDËSIA E DIASPORËS

Kosova konsiderohet si shtet me diasporë të madhe në proporcion me numrin e përgjithshëm e qytetarëve vendas. Burime të ndryshme dëshmojnë se jashtë vendit jetojnë diku mes të 400.000 dhe 600.000 qytetarë të Kosovës, të pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës, përderisa numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të diasporës shkon prej 800,000 deri në 1 milionë. Sipas të dhënave nga Raporti i Migrimit të vitit 2014 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), janë mbi 380,000 qytetarë që kanë lindur në Kosovë por që jetojnë jashtë saj, ndërsa mbi 50% e emigrantëve janë të vendosur në Gjermani dhe në Zvicër. Ndërkohë, vlerësohet se mbi 300.000 qytetarë jashtë vendit janë me të drejtë vote.

Diaspora e Kosovës ka qenë historikisht afër vendit të origjinës. Që nga vitet e 70-ta, ajo ka qenë një mirëmbajtëse e 'paqes sociale' përmes dërgimit të remitencave, të cilat kanë qenë burimi i vetëm financiar për shumë familje kosovare. Diaspora vazhdon të jetë kontribuese e madhe në ekonominë e Kosovës përmes dërgesave financiare të cilat përbëjnë rreth 15% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), por edhe përmes investimeve direkte. Por, ndërsa Kosova ka bërë njëfarë përparimi në njohjen e rëndësisë së diasporës, shumë pak është bërë në aspektin e përfaqësimit politik dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje.

<sup>1</sup> "Report On Out-Of-Country Voting". 2011. Venice Commission. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.as?pdffile=CDL-AD\(2011\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.as?pdffile=CDL-AD(2011)022-e).

<sup>2</sup> Krasniqi, Lirim. 2018. "Vota e Diasporës si Infuzion i Demokracisë". GERMIN & KALLXO.Com. <https://kallxo.com/gjate/mendime/vota-e-diaspores-si-infuzion-i-demokracise/>.

<sup>3</sup> "Migrimi Kosovar". 2014. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). <https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>.

<sup>4</sup> "Vendosja e Drejtësisë Në Zgjedhje: Shqyrtimi i Rasteve dhe Rruga Drejt Bashkëpunimit Institucional". 2015. Democracy For Development (D4D). <https://d4d-ks.org/assets/2015-07-10-Electoral-Justice-Report-ALB.pdf>.

## KORNIZA LIGJORE

Legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës në lidhje me votimin nga jashtë ka për bazë statusin e personave që jetojnë jashtë vendit. Fillimisht, rëndësi i kushtohet kualifikimit të personave si qytetarë që jetojnë jashtë vendit apo pjesëtarë të diasporës. Sipas Nenit 2 të Ligjit 04/L-215 për Shtetësinë, pjesëtar i Diasporës është *“çdo person që e ka qëndrimin e ligjshëm jashtë Republikës së Kosovës i cili dëshmon se ka lindur në Republikën e Kosovës, pjesëtar i diasporës konsiderohet edhe secili person i cili është pasardhës brenda një gjenerate i personit që ka lindur në Republikën e Kosovës.”*

Ndërsa, të pasurit e zotësisë juridike për të marrë pjesë në zgjedhje, Ligji 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 5, thekson se *“çdo person ka të drejtë të votojë në zgjedhje nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kriterëve vijuese: është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil; banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998; ka fituar statusin e refugjatit.”*

## PROCEDURA E REGJISTRIMIT SIVOTUES JASHTË VENDIT

Bazuar Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), harton kriteret proceduriale për qytetarët të cilët jetojnë jashtë Kosovës dhe duan të votojnë për zgjedhjet në Kosovë. Për tu përfshirë në Listën e Votuesve jashtë Kosovës, kriteret që duhet të dëshmohen sipas KQZ-së janë:

- Identiteti,
- Moshë,
- Të qenit pjesë e regjistrimit civil në Republikën e Kosovës, ose
- Të qenit banorë i Kosovës më 1 janar 1998, dhe
- Përmbytja e kriterëve të zotësisë juridike civile:

a) Të jeni lindur në Kosovë, b) Të keni njërin prind të lindur në Kosovë, c) Të keni jetuar në Kosovë për një periudhë të pandërprerë prej së paku pesë (5) vite radhazi, d) Të jeni detyruar të largoheni nga Kosova prandaj nuk keni pasur mundësi të banoni në Kosovë gjatë një periudhe vijuese prej pesë vjetësh, e) Të jeni fëmijë në varësi nën moshën 18 vjeçare (por që mund t'i mbushni 18 vjet deri në ditën e zgjedhjeve) të personit të regjistruar në Regjistrin Civil në Kosovë, f) Të jeni person në varësi nën moshën 23 vjeçare, i një personi të regjistruar në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës dhe të jeni student i rregullt i një institucioni të njohur të arsimit.

Për të dëshmuar përmbytjen e këtyre kriterëve për votim nga jashtë, dërgohet aplikimi në adresë të KQZ-së nëpërmjet postës elektronike (email), postës apo faksit. Më pastaj, KQZ e shqyrton nëse personi ka të drejtë të votojë dhe informon atë mbi pranimin apo refuzimin e aplikacioneve në bazë të kushteve të parashtruara për regjistrim.

Qytetarit të cilit i refuzohet aplikacioni për votim jashtë vendit, i lejoheq që të apelojë vendimin e KQZ në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrsa (PZAP) brenda njëzet e katër (24) orëve nga momenti i pranimit të refuzimit.

Atyre të cilëve iu është aprovuar kërkesa për regjistrim si votues jashtë Kosovës, KQZ-ja ua dërgon një njoftim përmes postës elektronike dhe shpall listën e personave me të drejtë vote, të regjistruar si votues jashtë vendit. Deri në vitin 2017, KQZ ka përdorur metodën e njoftimit përmes postës fizike, përmes së cilës ka dërguar në adresë të personave të regjistruar një fletëvotim të paplotësuar dhe listën e kandidatëve, udhëzimet mbi mënyrën e votimit si dhe adresën e KQZ-së ku votuesit duhet ta dërgojnë zarfin me fletëvotim. Nga viti 2017, KQZ ka filluar edhe përdorimin e postës elektronike për procedurat e aplikimit dhe njoftimit të votuesve nga jashtë, duke zgjeruar mundësitë dhe përsheptuar procesin e komunikimit me votuesit. Ndërsa në Zgjedhjet e vitit 2019 nuk është përdorur fare posta fizike për njoftimin e votuesve jashtë vendit. Ky ndryshim sado i vogël ka efekte pozitive në aspektin financiar por edhe ambientalist.

Regjistrimi për votim jashtë vendit është periudhë e veçantë e cila mund të zgjasë deri në katërdhjetë (40) ditë gjatë zgjedhjeve të rregullta dhe mund të shkurtohet deri në shtatë (7) ditë gjatë zgjedhjeve të parakohshme apo jashtëzakonshme. Sipas Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013, neni 3.5, në zgjedhjet e rregullta, periudha përfundon 60 ditë para ditës së zgjedhjeve. KQZ shqyrton të gjitha aplikacionet për të përcaktuar të drejtën e aplikuesve për votim. **Në Zgjedhjet e Parakohshme të vitit 2019, afati për regjistrim si votues jashtë Kosovës ka zgjatur 12 ditë, përkatësisht nga data 30 gusht deri me 10 shtator 2019.**

## PROCEDURAT E VOTIMIT

Në vitin 2013, KQZ-ja ka miratuar një Rregull të veçantë Zgjedhore (Nr. 03/2013) ku përcaktohen procedurat për votim nga jashtë. Personat e regjistruar suksesshëm si votues jashtë vendit dhe personat që janë regjistruar në zgjedhjet e kaluara dhe kanë dëshmuar zotësinë juridike si votues jashtë Kosovës, pranojnë njoftimin/konfirmimin zyrtar nga KQZ së bashku me fletëvotimin për zgjedhjet përkatëse. Për Zgjedhjet e Parakohshme të vitit 2019, KQZ ka njoftuar të gjithë aplikuesit përmes e-mailit dhe ka publikuar listën e personave të cilëve ju është njohur zotësia juridike për të votuar jashtë Kosovës. **Publikimi i listës së votuesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019 është përcjellë me shqetësim sepse në të janë përfshirë edhe të dhënat personale të qytetarëve që janë regjistruar si votues jashtë vendit.**

<sup>5</sup> "Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. "LIGJI NR. 03/L-034 PËR SHTETËSINË E KOSOVËS". Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Neni 2.

<sup>6</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. "LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS". Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Neni 5.

<sup>7</sup> "Procedura për vlerësimin e kriterëve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës: Votimi jashtë Kosovës". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). <http://www.kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/> (Qasur me 20 dhjetor, 2019.)

<sup>8</sup> Ky afat është përshtatur me periudhën e konfirmimit dhe kundërshtimit të listës së votuesve, e cila duhet të përfundojë deri në 40 ditë para ditës së zgjedhjeve. Ndërsa, afati në mes 60 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe 40 ditë para ditës së zgjedhjeve, është përcaktuar për periudhën e kundërshtimit, ku lista e votuesve (që përfshin votuesit brenda dhe jashtë vendit) të kundërshtohet dhe konfirmohet përgjatë kësaj periudhe.



Të gjithë personat e regjistruar sukseshëm si votues nga jashtë kanë pasur mundësi ta shkarkojnë fletëvotimin në ueb-faqen zyrtare të KQZ-së, pa pasur nevojë që të presin fletëvotimin origjinal që vinte me postë fizike në vitet paraprake. Sipas Rregullës Nr. 03/2013, Neni 4.2, votuesi jashtë Kosovës



*“pas plotësimit të fletëvotimit(eve) votuesi duhet të vendosë fletëvotimin(et) në një zarf të pashënuar e të mbyllur të vendosur brenda zarfit të jashtëm/për dërgim. Në zarfin e dërgimit votuesi gjithashtu vendosë një fotokopje të dokumentit të tij ose saj të vlefshëm të identifikimit dhe një shënim që përmban të dhënat personale të tij ose saj dhe që përmban së paku emrin, mbiemrin, emrin e babait dhe datën e lindjes së tij ose saj.”*



Votuesit gjithashtu mund t'i printojnë fletëvotimet nga shtëpitë e tyre (edhe format A4, bardhë dhe zi), kështu që nuk kanë nevojë që të presin fletëvotimin origjinal që vjen me postë. Pas plotësimit të fletëvotimit dhe futjes në zarf sipas kriterëve të vendosura nga KQZ, votuesi duhet ta dërgojë zarfin apo pakon me fletëvotimve me postë në njërën nga kutitë postare të KQZ-së, deri në datën përcaktuar nga kjo e fundit e që sipas Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme duhet të jetë një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve. Pakot postare të cilat përmbajnë zarfe të personave me mbiemra të ndryshëm apo që janë dëshmuar së nuk vijnë nga e njejta familje, nuk pranohen si të vlefshme ana e KQZ-së. Kështu ka ndodhur edhe në Zgjedhjet e vitit 2019.


<sup>9</sup> "RREGULLA ZGJEDHORE Nr.3/2013 - VOTIMI JASHTË KOSOVËS". 2013. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Neni 4.2. <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/KQZ-Rregulla-03-2013.pdf>.




**#votaediasporës**

## NUMRI I APLIKIMEVE, APROVIMEVE DHE VOTAVE TË VLEFSHME PËR ZGJEDHJET 2019

Për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi një periudhë 12 ditore (30 gusht - 10 shtator, 2019), brenda së cilës qytetarët jashtë Kosovës duhej të aplikonin për t'u regjistruar si votues jashtë. Gjatë kësaj periudhe kohore, KQZ pranoi 40 mijë e 313 aplikacione për regjistrim, prej të cilave (siç shihet në Figurën 1), 5 mijë e 327 aplikacione janë pranuar përmes postës fizike; 319 aplikacione janë pranuar përmes faksit dhe 34 mijë e 667 aplikacione janë pranuar përmes postës elektronike të shërbimit votues. Kjo tregon se përdorimi i postës elektronike është formë shumë më e përshtatshme dhe praktike për dërgimin e aplikacioneve për regjistrim si votues jashtë vendit.



Nga 40 mijë e 313 aplikacione për regjistrim si votues nga jashtë, janë aprovuar 35 mijë e 87 apo 87,04 %, ndërsa janë refuzuar 5 mijë e 226 aplikacione apo 12,96% (Figura 2), për shkak të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara me ligj. Rrjedhimisht, vetëm 35 mijë e 87 qytetarë kanë pasur të drejtën të dërgojnë fletëvotimet e tyre përmes postës si votues jashtë Kosovës.



<sup>910</sup> "Mbledhja e Datës 18 Shtator". 2019. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. <http://www.kqz-ks.org/lajmet/periudha-e-votimit-permes-postes-fillon-me-19-shtator/>.

Në krahasim me dy ciklet e kaluara të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të aplikimeve, e rrjedhimisht edhe pakove me fletëvotime nga jashtë të ardhura në adresë të KQZ-së (Figura 3). Në krahasim me zgjedhjet e vitit 2017 kur kishin aplikuar 20,354 qytetarë për t'u regjistruar si votues jashtë vendit, në vitin 2019 kemi një rritje prej 99% me 40,313 aplikues për regjistrim si votues jashtë vendit. Kjo reflektohet edhe në numrin e aplikimeve të aprovuara dhe pakove të dërguara, ku në vitin 2019 vërejmë një rritje të dukshme në krahasim me vitet paraprake kur janë mbajtur zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.




fig.03 Numri i aplikimeve, aprovimeve, dhe pakove me fletëvotime nga jashtë në katër ciklet zgjedhore për Kuvendin e Kosovës pas shpalljes së Pavarësisë

## PAKOT ME FLETËVOTIME NGA JASHTË PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE - 2019

Pas shpalljes së listës së votuesve jashtë Kosovës, KQZ ka përcaktuar afatet kohore për dërgimin e fletëvotimeve përmes postës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të vitit 2019. **Afati për dërgimin e fletëvotimeve përmes postës për Zgjedhjet e vitit 2019 ka zgjatur 17 ditë, nga data 19 shtator deri me 5 Tetor.** Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, brenda këtij afati, në adresën e saj postare kanë ardhur 15,794 dërgesa postare, përfshirë edhe ato nga Serbia. Ndërsa, pas datës së zgjedhjeve (6 tetor 2019) në adresën postare të KQZ-së,

<sup>11</sup> Pakoja me fletëvotime është zarfi me të dhënat e dërguesit/ve që arrin në fahun postar të KQZ-së, dhe mund të përmbajë më shumë se një fletëvotim.

<sup>12</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A.A.-U.ZH.nr.20/2019, datë 30.08.2019, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A.A.-U.ZH.nr.21/2019, datë 05.11.2019.

kanë arritur 6,445 pako me fletëvotime, të cilësuar si dërgesa që kanë arritur pas afatit dhe të cilat janë vlerësuar/pranuar, pas procesit të ankesave, sikurse ka vendosur Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, sipas aktgjykimeve A.A.-U.ZH.nr.20/2019 dhe A.A.-U.ZH.nr.21/2019.

Edhe sa i përket pakove të pranuar nga KQZ, në zgjedhjet e vitit 2019 vërehet një rritje e konsiderueshme në raport me zgjedhjet para-prake. Siç paraqitet në tabelën 1, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të vitit 2019, KQZ ka pranuar 24,523 pako me fletëvotime të individualizuara. Shprehur në përqindje i bie se 70% e qytetarëve të regjistruar sukseshëm si votues jashtë vendit kanë arritur të dërgojnë fletëvotimet e tyre përmes postës në adresë të KQZ-së.

	2010	2014	2017	2019
Afati i regjistrimit	N/A	7 ditë	7 ditë	12 ditë
Nr. i aplikacioneve të pranuar	5,015	29,745	20,354	40,313
Nr. i aplikacioneve të aprovuara (% nga aplikacionet e pranuar)	1,640 (32%)	16,569 (55%)	15,118 (74%)	35,087 (87%)
Nr. i pakove të pranuar (% nga aplikimet e aprovuara)	N/A	10,446 (63%)	9,157 (61%)	24,523 (70%)
Nr. i shteteve nga kanë ardhur aplikacionet	32	40	59	53

*Tabela 01. Të dhënat e votimit nga jashtë gjatë katër palë zgjedhjeve të fundit parlamentare*

Shifrat e zgjedhjeve të vitit 2014 janë më të mëdha jo për shkak të votave individuale nga jashtë, por për shkak të numrit më të madh të votave nga Serbia të cilat kanë ardhur në mënyrë të organizuar, ndërmjetësuar nga misioni i OSBE-së. Në vitin 2019, kemi 3,782 dërgesa (zarfe) nga Serbia, të cilat janë dërguar fizikisht në kutinë postare të KQZ-së. 3,782 votat nga Serbia janë anuluar pas vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.428/2019 të datës 10.12.2019, i cili është konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme, përmes aktgjykimit A.A.nr. 27/2019. Pas pranimit të të gjitha dokumentave, KQZ ka bërë vlerësimin e vlefshmërisë të të gjitha dërgesave, nga i cili proces janë refuzuar 4,323 dërgesa, për arsytet e e paraqitura në tabelën 2.


<sup>13</sup> "Raport përfundimtar për Periudhën e Votimit përmes postës – Votimi jashtë Kosovës 2019". 2019. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.



ARSYET E REFUZIMIT	NUMRI
Personat që nuk kanë aplikuar në periudhën e aplikimit për regjistrim	1,763
Aplikuesit e refuzuar gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim	357
Personat që kanë dërguar pako me fletëvotime më shumë se një herë	253
Personat që nuk janë identifikuar (që kanë dërguar vetëm fletëvotim) dhe persona që kanë dërguar pako me fletëvotime më shumë se persona të aprovuara	1,010
Personat që nuk kanë dëshmuar identitetin me dokumente valide të identifikimit që kanë dërguar kopje të dokumenteve me afat të skaduar)	940
<b>TOTALI</b>	<b>4,323</b>

*Tabela 02. Pakot me fletëvotime të refuzuara pas procesit të verifikimit nga KQZ*

Në total, nga 35,087 votues të regjistruar suksesshëm, 24,523 kanë arritur të dërgojnë fletëvotimet përmes postës, ndërsa vetëm 20,200 personave u janë aprovuar dërgesat si të vlefshme. Shprehur në përqindje, nga 35,087 votues të regjistruar suksesshëm, pakot me fletëvotime kanë arritur t'i dërgojnë 20,200 votues, apo 57.57% e votuesve të regjistruar suksesshëm (Figura 4).



*fig.04 Pakot e aprovuara dhe refuzuara pas procesit të vlersimit nga KQZ*

<sup>19</sup> "Raport përfundimtar për Periudhën e Votimit përmes postës – Votimi jashtë Kosovës 2019". 2019. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

## VOTAT E VLEFSHME SIPAS SHTETEVE DËRGUESE

Dërgesat postare me fletëvotime për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës kanë ardhur nga 53 shtete të ndryshme. Më së shumti dërgesa kanë ardhur nga vendet evropiane si: Gjermania, Zvicra, Austria, Suedia, Italia, Franca por edhe SHBA-ja (Tabela 3).

Tabela 3. Numri i pakove të aprovuara sipas shtetit të dërgesës

SHTETI	Nr. i pakove të aprovuara	SHTETI	Nr. i pakove të aprovuara
01. GJERMANI	7,684	28. BOSNJE DHE HERCEGOVINË	15
02. ZVICËR	7,077	29. IRLANDË	12
03. AUSTRI	860	30. SHQIPËRI	10
04. FRANCË	643	31. EMIRATET E BASHKUARA ARABE	10
05. SUEDI	633	32. SKOCI	9
06. ITALI	548	33. ISLANDË	7
07. SHBA	483	34. SPANJË	6
08. BELGJIKË	375	35. MONGOLI	6
09. MBRETËRIA E BASHKUAR	308	36. SERBI	6
10. NORVEGJI	264	37. SLLOVAKI	5
11. FINLANDË	237	38. JAPONI	4
12. KAZAKISTAN	224	39. PORTUGALI	3
13. SLLOVENI	162	40. KOLUMBI	3
14. DANIMARKË	138	41. POLONI	2
15. LUKSEMBURG	72	42. ZELANDA E RE	2
16. KANADA	61	43. SIRI	1
17. HOLANDË	60	44. BAHREIN	1
18. TURQI	58	45. ARABI SAUDITE	1
19. AUSTRALI	33	46. MALAJZI	1
20. MALI I ZI	29	47. AZERBEJXHAN	1
21. KROACI	24	48. SENEGAL	1
22. RUMANI	23	49. ARMENI	1
23. LIHTENSHTAJN	22	50. IZRAEL	1
24. MAQEDONI E VERIUT	22	51. KOLUMBI	1
25. REPUBLIKA ÇEKE	17	52. NIGERI	1
26. BULLGARI	16	53. IRAK	1
27. HUNGARI	15		
		<b>TOTALI</b>	<b>22,200</b>

Shprehur në përqindje, dërgesat nga Gjermania dhe Zvicra së bashku mbulojnë mbi 70% të të gjitha pakove me fletëvotime, me 40.3%, respektivisht 30.8% të totalit të pakove të aprovuara nga KOZ.

## PAKOT ME FLETËVOTIME TË ARDHURA NË KQZ PAS AFATIT LIGJOR

Gjatë procesit të verifikimit të vlefshmërisë së pakove të ardhura përmes postës, Organizata GERMIN përmes vëzhguesve të saj të akredituar nga KQZ, ka vërejtur se nuk janë marrë parasysh fare plot 6,445 pako, të cilat edhe pse janë dërguar para afatit ligjor të vendosur nga KQZ-ja, kanë arritur në adresë të kësaj të fundit pas datës 5 tetor. **Organizata GERMIN ka vëzhguar për herë të dhe ekskluzivisht procesin e pranimit, verifikimit dhe numërimit të votave nga jashtë.**

Vëzhguesit e GERMIN kanë identifikuar më pastaj edhe datat e dërgimit të pakove të papranuara nga KQZ dhe kanë vërtetuar se të gjitha janë dërguar brenda afatit, mirëpo për shkaqe teknike të postës nuk kanë arritur në kohë. Figura 5 paraqet të dhënat mbi datat e dërgimit të 6,445 pakove me fletëvotime, të cilat kanë arritur pas afatit të vendosur nga KQZ. Siç shihet në figurën 5, të gjitha paketat janë nisur si dërgesa postare para afatit ligjor, përjashtimisht 371 pakove, data e dërgimit e të cilave ka qenë e paidentifikueshme.




fig. 05 Numri i dërgesave postare sipas datës së dërgimit të pakove të ardhura pas afatit ligjor (5 tetor 2019)

GERMIN ka reaguar për mos pranimin e këtyre pakove nga Shërbimi i Votuesve të KQZ-së, duke ushtruar ankesë në PZAP për dy dengjet e pakove nga jashtë (4,639 dhe 1,806), dhe pas refuzimit nga kjo e fundit është ushtruar apeli në Gjykatën Supreme. Për të njejtën çështje është ankuar edhe subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje". Poashtu, GERMIN ka iniciuar rastin edhe tek Institucioni i Avokatit të Popullit, lidhur me shkeljen e të drejtave zgjedhore të qytetarëve jashtë vendit.

<sup>14</sup> "ANKESË Drejtuar PZAP: Për Shkeljen e së Drejtës së Votës ndaj Qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit". 2019. OJQ GERMIN. <https://germin.org/ankese-drejtuar-pzap-per-shkeljen-e-se-drejte-se-votes-ndaj-qytetareve-te-republikes-se-kosoves-qe-jetojne-jashte-vendit/>.

<sup>15</sup> "APEL i vendimit Anr. 382/2019 të PZAP: drejtuar Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës" 2019. OJQ GERMIN. <https://germin.org/germin-paraqet-ankese-ne-gjykatën-supreme-per-mosnumerimin-e-1806-pakove-me-fletevotime-nga-diaspora-nga-ana-e-kqz-se/>

Arsyetimi i KQZ-së për mospranimin e këtyre pakove bazohet në Nenin 96.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjishme dhe Nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013, ku thuhet se "Votat Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja 24 orë para ditës së Zgjedhjeve". Pavarësisht se proceduralisht KQZ kishte të drejtë, mospranimi i votave të dërguara me postë pas afatit të përcaktuar nga dokumentet e lartcekura, përbën cënim të të drejtave zgjedhore të garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtare.

Kufizimi i afatit kohor për pranimin e votave jashtë Kosovës përmes nenit 96 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr. 03/2013, është në kundërshtim me nenin 45, lexuar bashkë me nenin 55 të Kushtetutës, pasi që nuk përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. Neni 55, par. 2 i Kushtetutës përcakton se: "Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi". Nëse qëllimi i vendosjes së afatit prej 24 orëve para ditës së zgjedhjeve për pranimin e votave jashtë Kosovës është që të mos shkaktohen vonesa në procedimin dhe numërimin e votave, atëherë ky qëllim, ndonëse është legjitim, nuk e justifikon refuzimin për të pranuar pakot e ardhura pas këtij afati. Kjo për arsye se numërimi i votave të ardhura me postë, pothuajse në asnjë palë zgjedhje nuk ka përfunduar më herët se një javë pas përfundimit të procesit zgjedhor brenda Kosovës. Kjo do të thotë se numërimi i këtyre pakove të ardhura me postë, nuk do të kishte vonuar procesin e numërimit të votave tjera të ardhura brenda afatit ligjor. Me fjalë të tjera, vendosja e kufizimit të rreptë prej 24 orësh para ditës së zgjedhjeve, nuk del të jetë e domosdoshme që të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi, siç thotë edhe neni 55, par. 2 të Kushtetutës. Kufizimi ligjor, në mënyrë që të jetë i lejueshëm duhet të ketë qëllim legjitim dhe duhet të jetë masë proporcionale për të arritur atë qëllim.

Më tej, përgjegjësia për arritjen me vonesë të pakove me fletëvotime nga jashtë nuk është e votuesve. Për shkaqe objektive të vonesave të shërbimeve postare nuk mund të privohen nga e drejta kushtetuese qytetarët që jetojnë jashtë vendit. Këtë gjë e konfirmon edhe Gjykata Supreme përmes aktgjykimit A.A.UZH.nr. 20/2019, e cila konstaton se "neni 96 par. 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe neni 4 par. 4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 janë në kolizion me nenin 3 të Protokollit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili përfshin të drejtën për zgjedhjet e lira, dhe në rastin konkret votuesit pa fajin e tyre ishin privuar nga mundësia për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës, votuesve u është mohuar veti thelbi i së drejtës për të votuar, siç garantohej nga neni 3 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

<sup>16</sup> "Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. "LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS". Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.



---

## PENGESAT NË PROCESIN E VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT

Nga të dhënat e prezantuara më lart, por edhe nga evidenca procesve të deritanishme zgjedhore vërehen disa pengesa të cilat ndikojnë që të kemi një numër të vogël të qytetarëve jashtë Kosovës që marrin pjesë në zgjedhje. Më poshtë janë një listë e barrierave të votimit nga jashtë, disa prej të cilave janë përmendur edhe në konsultimet e vazhdueshme që organizata GERMIN i bën me pjesëtarët e diasporës:

**1. MUNGESA E DOKUMENTEVE TË IDENTIFIKIMIT:** Shumë qytetarë që jetojnë jashtë vendit duke marrë shtetësinë dhe dokumentet tjera në vendet rezidente, kanë hequr dorë nga shtetësia e Kosovës apo nuk i kanë përditësuar dokumentet e identifikimit të Kosovës për një kohë të gjatë. Kjo ndikon në pamundësinë e dëshmimit të kriterëve të zotësisë juridike, siç kërkohet nga KQZ për të votuar. Prandaj, një pjesë e konsiderueshme e tyre, duke pasur parasysh procedurat burokratike për përditësimin e dokumenteve dhe mungesën e asistencës institucionale, janë të “përyshuar” që në fillim të procesit të votimit nga jashtë.

**2. MUNGESA E NJOHURIVE PËR TË DREJTAT ZGJEDHORE DHE PROCEDURAT E KOMPLIKUARA TË APLIKIMIT/VOTIMIT:** Qytetarët e Kosovës jashtë vendit në shumë raste nuk kanë njohuri për të drejtat e tyre zgjedhore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës. Shumë pjesëtarë të diasporës kanë pak informacion për të drejtat, duke filluar që nga të drejtat për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur e deri tek të drejtat dhe procedurat e ankesës, etj. Pa qenë të informuar lidhur me të drejtat zgjedhore dhe pa e ditur rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje, qytetarët jashtë vendit janë shumë më pak të prirur të votojnë. Poashtu, procedurat e votimit me postë janë burokratike dhe dekurajuese për një pjesë të votuesve potencial. Printimi dhe plotësimi i formularëve në procedurat e aplikimit dhe regjistrimit, kopjimi dhe skanimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe procedurat e dërgimit të fletëvotimit përmes zarfeve në postën e KQZ-së janë procedura që kanë kosto kohore dhe financiare dhe në shumë raste janë dekurajuese për një pjesë të qytetarëve jashtë vendit.

**3. AFATET E SHKURTËRA PËR APLIKIM/REGJISTRIMIN DHE VOTIM:** Gjatë cikleve të rregullta zgjedhore votuesit nga jashtë mund t’i dërgojnë aplikacionet për regjistrim mes periudhës, jo më herët se 25 ditë nga shpallja e zgjedhjeve dhe jo më vonë se 60 ditë para ditës së zgjedhjeve. Gjithsesi, ky afat kohor, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 dhe 2017 është shkurtuar deri në 7 ditë, edhe për shkak se ato kanë qenë të parakohshme. Afati shumë i shkurtër nuk lejon shumë hapësirë për qytetarët jashtë vendit për të përmbushur të gjitha kriteret në procesin e votimit nga jashtë. Poashtu, edhe për ata që regjistrohen suksesshëm, afati për dërgimin/arritjen e zarfeve me fletëvotime në adresë të KQZ-së mbetet sfidues, duke pasë parasysh vonesat postare, të cilat nuk janë përgjegjësi e votuesve. Zgjedhjet e vitit 2019 dëshmuar se një numër i madh i qytetarëve jashtë vendit kanë mundur mos të realizojnë të drejtat e tyre zgjedhore për shkak të arritjes së fletëvotimeve pas afatit ligjor.

**4. TRAJTIMI JO-SERIOZ I VOTIMIT NGA JASHTË DHE ÇËSHTJEVE TË LIDHURA ME DIASPORËN:** Subjektet politike kosovare nuk janë shumë aktive jashtë vendit. Duke qenë se aktiviteti jashtë vendit është më i kushtueshëm dhe më sfidues, si dhe duke pasur parasysh procesin e ndërlikuar të votimit nga jashtë, subjektet politike nuk e trajtojnë votën nga jashtë si potencial elektoral, prandaj targetimi i qytetarëve jashtë vendit është më i dobët. Si pasojë, çështjet që i përkasin qytetarëve jashtë vendit humbin prioritetin në programet dhe aktivitetet e subjekteve politike. Edhe kur trajtohen, çështjet e diasporës përdoren vetëm për konsum të brendshëm. Në këtë drejtim, edhe votimi nga jashtë deri më tani është parë si çështje dytësore në debatin për reformën zgjedhore. Me përjashtime të vogla, një pjesë e madhe e akterëve politik në heshtje e injorojnë përmirësimin e këtij procesi, ndërsa institucionet e thirrura për të bërë veprimet e nevojshme nuk e trajtojnë seriozisht atë.

**5. MUNGESA E KAMPANJAVE INFORMUESE TË VAZHUESHME:** Informimi i votuesve nga diaspora vazhdon të mbetet një pikë që kërkon më shumë punë dhe angazhim. KQZ viteve të fundit ka ndërmarrë disa veprime duke targetuar votuesit jashtë vendit, si shembull vendosja e fletushkave informuese në Aeroportin e Prishtinës, që njoftojnë votuesit mbi procedurat e votimit përderisa ata largohen nga Kosova. Poashtu, KQZ-ja ka vënë në dispozicionin përdorimin e metodave elektronike për aplikim dhe regjistrim, dhe një qasje të lehtë në fletëvotime dhe broshura të kandidatëve, pasi që janë të disponueshme në ueb faqen e KQZ. Gjithsesi, përveç kampanjave që organizohen në prag të zgjedhjeve, vërehet një mungesë e angazhimit të vazhdueshëm institucional për informim dhe edukim të votuesve nga jashtë. Në këtë drejtim, informimi dhe edukimi mund të jetë më i targetuar duke shfrytëzuar edhe kapacitetet e ambasadave dhe konsullatave të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Jashtme dhe Diasporës, por edhe organizatave të ndryshme të diasporës jashtë vendit.



## REKOMANDIME

Duke u marrë parasysh rëndësinë e diasporës për Kosovën, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve jashtë vendit në vendimmarrje, Organizata GERMIN jep këto rekomandime:

### 1. VOTIMI FIZIK NË MISIONET DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Të ndryshohet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe të mundësohet votimi fizik në ambasadat dhe konsullatat të Republikës së Kosovës. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit gjatë legjislaturës së 6-të ka hartuar Projektligjin për ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar Me Ligjin Nr. 03/L-256, ku parashihet votimi në misionet diplomatike dhe konsullore të Kosovës për qytetarët jashtë vendit, mirëpo ky projektligj nuk ka kaluar për lexim dhe votim në Kuvend. Miratimi i këtij projektligji do të zgjeronte mundësitë e ushtrimit të të drejtave zgjedhore për qytetarët jashtë vendit.

### 2. ZGJATJA E AFATIT PËR ARRITJEN E ZARFEVE ME FLETËVOTIME

Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A.A.-U.ZH.nr.20/2019, datë 30.08.2019, dhe A.A.-U.ZH.nr.21/2019, datë 05.11.2019, e kanë bërë pothuajse të pavlerë Nenin 96.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013 për arritjen e votave nga jashtë 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Rrjedhimisht, afati për pranimin e votave nga jashtë duhet të zgjatet deri në 5 apo 7 ditë pas ditës së zgjedhjeve, me kusht që data e dërgimit të jetë para ditës së zgjedhjeve, gjë që mund të vërtetohet përmes vulës postare.

### 3. DËRGIMI I POSTËS NË AMBASADA DHE KONSULLATA TË REPUBLIKËS

Përveç mundësisë së votimit fizik, zgjerimi i mundësive për votim për pjesëtarët e diasporës duhet të përfshij edhe mundësinë e dërgimit të postës në ambasadat dhe konsullatat e Kosovës në vendin rezident të qytetarëve jashtë vendit. Kjo pasiqë në disa vende distanca mes venbanimit dhe misionit diplomatik dhe konsullor të Kosovës është e madhe, prandaj duhet të krijohet mundësia që vota me postë të dërgohet në misionin diplomatik/konsullor në të njëjtin shtet, krahas mundësisë për dërgimin e postës në adresë të KQZ-së. Votat përmes postës arrijnë shumë më shpejtë brenda territorit të një shteti. Ndërsa të njëjtat, misioni diplomatik apo konsullor mund t'i dërgojë me postë diplomatike në adresë të KQZ-së. Kështu edhe zgjerohen mundësitë e votimit, edhe procesi përshejtohet.

### 4. ZHVILLIMI I NJË PLATFORME ELEKTRONIKE PËR APLIKIM PËR REGJISTRIM NË UEB-FAQEN E KQZ-SË

Formave aktuale të aplikimit për regjistrim si votues nga jashtë vendi, rekomandohet t'u shtohet edhe një platformë elektronike në uebfaqen e KQZ-së e cila do të mundësonte aplikimin online për regjistrim (ueb-based). Një platformë e tillë do të: (1) lehtësonte dhe thjeshtësonte në krahasim me formën aktuale manuale duke qenë se nuk do të kishte nevojë për printim/plotësim të formularit; (2) zvogëlonte mundësitë e gabimeve në futjen e të dhënave, duke qenë se ajo mund të konfigurohet që të mos pranojë të dhënat e gabuara dhe aplikuesit do të mund të korrigjonin të dhënat e tyre; (3) menjanonnte mbingarkesën e e-mailit zyrtar të KQZ-së që ka qenë problem në zgjedhjet e kaluara.

### 5. REGJISTRIMI I PLOTË I QYTETARËVE QË JETOJNË JASHTË VENDIT

Regjistrimi i pjesëtarëve të diasporës nga ish-Ministria e Diasporës nuk ka arritur të mbledhë të gjitha të dhënat e qytetarëve jashtë vendit. Mirëpo edhe si i tillë, ky regjistër nuk është përdorur deri më tani nga ana e KQZ-së për krijimin e një liste të veçantë të qytetarëve jashtë vendit e cila mund të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Poashtu, Ministria e Punëve të Brendshme duhet të bashkëpunoj me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të vendos një kod identifikues për shtetasit e Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit në regjistrin civil, sikurse që ekziston kodi për shtetasit që nxjerrin dokumente të Republikës së Kosovës në ambasada dhe konsullata jashtë vendit.

### 6. VOTIMI VETËM ME DOKUMENTE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Për të eliminuar çfarëdo dyshimi apo mundësie për manipulim, vetëm dokumentet valide të Republikës së Kosovës duhet të pranohen si të vlefshme nga KQZ për votim jashtë vendit. Edhe kjo çështje është paraparë të ndryshohet me ndryshimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Gjithsesi, kjo duhet të realizohet duke vënë në lëvizje edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratën Publike (MPBAP), pasi siç e kemi cekur më lart, mungesa e posedimit të dokumenteve valide të Republikës së Kosovës nga pjesëtarët e diasporës apo votuesit potencial nga jashtë është një nga pengesat në pjesëmarrjen në zgjedhje. Prandaj, pajisja dhe përditësimi me dokumente valide të Republikës së Kosovës për qytetarët jashtë vendit është çështje e cila qëndron në raport kauzal me rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje.





## SHËNIM

Organizata GERMIN, që nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2017, ka nisur kampanjën **“Vota e Diasporës”**, me qëllim sensibilizimin e opinionit të gjerë brenda dhe jashtë Kosovës, mbi rëndësinë dhe procedurat e votimit nga jashtë, me fokus pjesëtarët e diasporës. Përmes njoftimeve të detajuara, shkriemeve që theksojnë rëndësinë e votës nga jashtë dhe infografikave të dërguara nëpërmjet kanaleve dhe platformave dixhitale, GERMIN ka arritur të përçojë informacione tek një numër i madh i pjestarëve të diasporës, të cilët kanë zotësitë juridike për të ushtruar të drejtat zgjedhore në Kosovë. Kampanja **“Vota e Diasporës”** ka vazhduar edhe gjatë procesit të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të vitit 2019, duke u zgjeruar edhe më tej aktivitetet. Në këtë drejtim është hartuar edhe kjo analizë, e cila trajtojn votimin nga jashtë dhe paraqet karakteristikat kryesore të këtij procesi, me fokus në Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës - 2019.

## BIBLIOGRAFIA

1. "ANKESË Drejtuar PZAP: Për Shkeljen e së Drejtës së Votës ndaj Qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit". 2019. OJQ GERMIN.  
<https://germin.org/ankese-drejtuar-pzap-per-shkeljen-e-se-drejt-es-se-votes-ndaj-qytetareve-te-republikes-se-kosoves-qe-jetojne-jashte-vendit/>
2. "APEL i vendimit Anr. 382/2019 të PZAP: drejtuar Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës" 2019. OJQ GERMIN.  
<https://germin.org/germin-paraqet-ankese-ne-gjykatene-supreme-per-mosnumerimin-e-1806-pakove-me-fletevotime-nga-diaspora-nga-ana-e-kqz-se/>
3. "Mbledhja e Datës 18 Shtator". 2019. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. <http://www.kqz-ks.org/lajmet/periudha-e-votimit-permes-postes-fillon-me-19-shtator/>
4. "Migrimi Kosovar". 2014. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).  
<https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>
5. "Raport përfundimtar për Periudhën e Votimit përmes postës – Votimi jashtë Kosovës 2019". 2019. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
6. "Report On Out-Of-Country Voting". 2011. Venice Commission.  
[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2011\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2011)022-e)
7. "RREGULLA ZGJEDHORE Nr.3/2013 - VOTIMI JASHTË KOSOVËS". 2013. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.  
<http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/KQZ-Rregulla-03-2013.pdf>
8. "Vendosja e Drejtësisë Në Zgjedhje: Shqyrtimi i Rasteve dhe Rruga Drejt Bashkëpunimit Institucional". 2015. Democracy For Development (D4D).  
<https://d4d-ks.org/assets/2015-07-10-Electoral-Justice-Report-ALB.pdf>
9. "VOTIMI NGA JASHTË VENDIT: Shqyrtimi i Politikave dhe Rekomandime Praktike". 2018. Instituti Demokraci Për Zhvillim (D4D) Dhe Demokraci Plus (D+). [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2018/10/D4D\\_Elec\\_13\\_SHQ.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2018/10/D4D_Elec_13_SHQ.pdf)
10. "Procedura për vlerësimin e kriterëve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës: Votimi jashtë Kosovës". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). <http://www.kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/> (Qasur me 20 dhjetor, 2019.)
11. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A.A.-U.ZH.nr.20/2019, datë 30.08.2019, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A.A.-U.ZH.nr.21/2019, datë 05.11.2019.
12. Krasniqi, Lirim. 2018. "Vota e Diasporës si Infuzion i Demokracisë". GERMIN & KALLXO.Com. <https://kallxo.com/gjate/mendime/vota-e-diaspores-si-infuzion-i-demokracise/>
13. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. "LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS". Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
14. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. "LIGJI NR. 03/L-034 PËR SHTETËSINË E KOSOVËS". Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.



# VÓTA E DIASPORËS

#votaediasporës2019

#Diasporaflet

[www.diasporaflet.org](http://www.diasporaflet.org)

